REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE

Nr. 7837 prot. Lushnje më, 25.09/...../2023

VENDIM

NR. 381 DATë 25/09/ 2023

"MBI MIRATIMIN E KODIT ETIK PËR AUDITUESIT E BRENDSHËM NË BASHKINË LUSHNJE"

Ne baze te ligjit nr.139/2015 date 17.12.2015 "Per veteqeverisjen vendore"*(i ndryshuar)*, ligjit 114/2015 datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik"*(i ndryshuar);*

VENDOSA:

1. Miratimin e Kodit Etik për Audituesit e Brendshëm, në Bashkinë Lushnje, i cili i bashkëngjitet këtij vendimi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Zyra e Auditimit.
3. Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

KRYETARI I BASHKISË
ERISELDA SEFA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA LUSHNJE

Adresa: Lagjia "Kongresi" Tel/Fax: +355 35 22139 E-mail: bashkia_lushnje@yahoo.com

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE

MIRATOI
KRYETARE E BASHKISË
ERISELDA SEFA



KODI ETIK
PËR AUDITUESIT E BRENDSHËM NË BASHKINË LUSHNJE

Kodi i etikes i bazuar në Kodin e Etikes së Institutit të Ndërkombëtar të Audituesve të Brendshëm (IIA) përmban parimet që rregullojnë sjelljen e audituesve të brendshëm në Bashkinë Lushnje në kryerjen e shërbimeve të auditit të brendshëm. Ky dokument përshkruan kërkesat minimale për sjelljen dhe pritshmëritë e sjelljes së audituesve të brendshëm, pra nuk përfshin aktivitete të veçanta të veprimtarisë audituese.

I. QËLLIMI I KODIT TË ETIKËS

Kodi i Etikës ka për qëllim të promovojë një kulturë etike në profesionin e auditimit të brendshëm. Kodi i Etikës është i nevojshëëm dhe i përshtatshëm për profesionin e auditimit të brendshëm, i krijuar për të vendosur besimin dhe sigurimin objektiv në lidhjje me qeverisjen, menaxhimin e riskut dhe kontrollin.
Auditimi i Brendshëm është një veprimtari e pavarur, që jep një siguri objektive, si edhe ofron këshillim per menaxhimin, e projektuar për të shtuar vlerën dhe për të përmirësuar veprimtarinë e njësisë publike.
Auditimi i Brendshëm ndihmon njësinë publike për të arritur objektivat, nëpërmjet një veprimtarie të disiplinuar dhe sistematike, për të vlerësuar e përmirësuar frytshmërinë e menaxhimit të riskut, si edhe proceset e kontrollit dhe të qeverisjes .
Ky kod, shtrihet përtej përkufizimit të auditit të brendshëm dhe përfshin dy komponentë thelbësor :
1) Parimet, të cilat janë të përshtatshme për profesionin dhe praktikën e auditimit të brendshëm ;
2) Rregullat e mirësjelljes, duke përfshirë normat dhe sjelljen që pritet nga audituesit e brendshëm. Keto rregulla ndihmojne në interpretimin e parimeve për zbatimin praktik të tyre dhe kanë si qëllim të udhëzojnë sjelljen etike të audituesve të brendshëm.

Auditues i Brendshëm, është profesionisti, i kualifikuar dhe i çertifikuar sipas kërkesave të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe që kryen shërbimin e auditimit të brendshëm, në përputhje me perkufizimin e auditimit të brendshëm.

II. FUSHA E VEPRIMIT

Ky Kod Etik , zbatohet nga punonjësit që ofrojnë shërbime të auditimit të brendshëm në Bashkinë Lushnje. Për të gjithë Audituesit e Brendshëm të çertifikuar në detyrë ,shkeljet e Kodit të Etikës do të vlerësohen dhe administrohen sipas akteve ligjore në fuqi.

III. PARIMET DHE RREGULLAT E SJELLJES PARIMET

1. Integriteti

Integriteti i Audituesve të Brendshëm krijon besimin dhe në këtë mënyrë siguron bazën për mbvështetje të gjykimit të tyre.

2. Objektiviteti

Audituesit e Brendshëm shfaqin nivelin më të lartë të objektivitetit profesional në mbledhjen, vlerësimin dhe komunikimin e informacionit në lidhje me aktivitetin ose proçesin që auditohet. Audituesit e Brendshëm kryejnë vlerësim të balancuar të të

gjithave rrethanave përkatëse dhe nuk ndikohen nga interesat e tyre personale ose nga të tjerët në nxjerrjen e konkluzioneve dhe në dhënien e rekomandimeve.

3. Konfidencialiteti

Audituesit e Brendshëm duhet të respektojnë vlerat dhe pronësinë e të dhënave që mbledhin dhe të mos zbulojnë ndonjë informacion nëse ata nuk kanë autoritetin ose ndonjë detyrim ligjor për ta bërë këtë.

4. Kopetenca:

Audituesit e Brendshëm duhet të zbatojnë dhe përdorin njohuritë, aftësitë dhe përvojën në ofrimin e shërbimit të auditimit të brendshëm .

IV. RREGULLAT E SJELLJES

1. Integriteti

Audituesit e Brendshëm :

1.1 Duhet të kryejnë punën e tyre me ndershmëri, zell dhe pergjegjësi;

1.2 Duhet të respektojne ligjin dhe të bëjnë dhënien e informacioneve shpjeguese të udhëhequra nga ligji dhe profesioni;

1.3 Nuk duhet me vetëdije të jenë palë në ndonjë aktivitet të paligjshëm ose të angazhohen me akte diskredituese për profesionin e auditimit të brendshëm ose të organizatës;

1.4 Duhet të respektojnë dhe kontribuojnë në arritjen e objektivave legjitime dhe etike të njësisë publike.

2. Objektiviteti

2.1 Nuk duhet të marrin pjesë në asnjë aktivitet ose marrëdhënie që mund të dëmtojë ose parashikon të dëmtojë vlerësimin e paanshëm. Kjo pjesëmarrje përfshin ato veprimtari që mund të jenë në konflikt me interesat e njësise publike;

2.2 Nuk duhet të pranojnë asgjë që mund të dëmtojë ose parashikon te dëmtojë gjykimin profesional;

2.3 Duhet të raportojnë të gjitha faktet e njohura prej tyre, të cilat nëse nuk zbulohen shkaktojnë shtrembërim të raportimit të proçesit nën auditim.

3. Konfidencialiteti

Audituesit e Brendshëm :

3.1 Duhet të jenë të kujdeshëm në përdorimin dhe ruajtjen e informacionit të mbledhur gjatë veprimtarisë së auditimit të brendshëm .

3.2 Nuk duhet te përdorin informacionin për përfitime personale apo ndonjë formë tjetër,në kundërshtim me ligjin ose që cënon objektiivat legjitime dhe etike të njësisë qe auditohet.

4. Kompetenca

Audituesit e Brendshëm ;

4.1 Duhet të angazhohet vetëm në veprimtarinë audituese, për të cilën ata kanë njohuritë e nevojshme, kompetencën dhe përvojën të duhur.

4.2 Duhet të kryejnë veprimtarinë e auditit të brendshëm në përputhje me kuadrin rregullator të auditit të brendshëm dhe të Standarteve Ndërkombëtare për Praktikën Profesionale të auditit të brndshëm (IPPF), të pranuara për t'u zbatuar.

4.3 Duhet vazhdimisht të permirësojnë aftësite e tyre dhe efektivitetin e cilësinë e shërbimeve të tyre.

Konc:
S.Gorovelli
A.Hajdinaj